



## STATUTI I FEDERATËS SHQIPTARE TË PESHKIMIT SPORTIV

### **KREU I PARIME TË PËRGJITHSHME**

#### **NENI 1 Forma Ligjore, Përbërja, Selia**

1. Federata Shqiptare e Peshkimit Sportiv themelohet sot më 10.01.2017 (për efekt të këtij statuti këtu e më poshtë do ti referohemi FSHPS), e cila është person juridik privat që krijohet në formën e shoqatës, e cila përfaqëson bashkimin vullnetar të shoqatave dhe klubeve sportive të Peshkimit Sportiv në Republikën e Shqipërisë, e cila vepron në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9376 datë 21.04.2005 "Për Sportin", Kodit Civil, Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", si dhe ligjit 8789 datë 07.05.2001 "Për rregjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse" si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këte aktivitet.
2. Federata Shqiptare e Peshkimit Sportiv, do të anëtaresohet në Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar, Federatën Botërore, Europiane të peshkimit sportiv dhe si anëtare e këtyre organizmave do të respektojë statutin dhe rregulloret, direktivat dhe vendimet e tyre si dhe do të sigurojë respektimin e tyre nga të gjithë anëtarët te saj.
3. Selia e FSHPS ndodhet në qytetin e Tiranës në adresën: Rruga:"Hoxha Tahsin", Pallati Vjetro, Nr.1, Shk.1, Ap.2, Tiranë

#### **NENI 2 FLAMURI, EMBLEMA DHE LOGO**

1. Federata Shqiptare e Peshkimit Sportiv mban siglen e Federates Shqiptare të Peshkimit Sportiv.



2. Federata Shqiptare e Peshkimit Sportiv ka stemën dhe flamurin e saj.
3. Vula e FSHPS-së është në formë rrumbullake.

### NENI 3

### QËLLIMI DHE FUNKSIONET

1. Federata Shqiptare e Peshkimit Sportiv është organizatë jofitimprurëse. Të ardhurat që krijohen në FSHPS nga burime të ndryshme ligjore rinvestohen 100% për zhvillimin e aktivitetit të FSHPS-së.
2. Federata Shqiptare e Peshkimit Sportiv ka këto objektiva dhe detyra:
  - a. Të zhvillojë, promovojë, kontrollojë dhe rregullojë aktivitetin sportiv të shoqatave dhe klubeve të FSHPS-së në sportin e peshkimit, në të gjitha format e në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me këtë statut dhe ligjet në fuqi;
  - b. Të përfaqësojë Republikën e Shqipërisë në aktivitete kombëtare dhe nderkombetare;
  - c. Të organizojë Kampionate Kombëtarë dhe Kupen e Shqipërisë dhe të shpallë ekipin Kampion Kombëtar dhe ekipin fitues të kupës së Shqipërisë si dhe aktivitete të tjera.
  - d. Të organizojë ekipin kombëtar dhe të marrë pjesë në veprimtaritë sportive ndërkombëtare ose të autorizojë pjesëmarrjen e anëtarëve të saj në këto veprimtari;
  - e. Të organizojë në Republikën e Shqipërisë veprimtari sportive ndërkombëtare dhe të japë leje për organizimin e tyre nga anëtarët e saj;
  - f. Të organizojë Kampionatin Kombëtar dhe Kupën e Shqipërisë në teknikat Surfcasting, Longcasting, Spinning, Peshkim nga varka, Peshkim me tapë si dhe të gjitha teknikat e peshkimit sportiv.
  - g. Organizimi i aktiviteteve sportive kurse, seminare, takime profesionale, konsultime, shkëmbim eksperincash.
  - h. Të organizojë gara Kombëtarë dhe Nderkombëtare si dhe të marrë pjesë në turne dhe kampionate.



## **KREU II** **ANËTARËSIA**

### **NENI 4**

1. Anëtarët e FSHPS-së duhet të jenë subjekte/ente të njohura, Ligji për Sportin”, të cilat pranojnë aderimin në FSHPS, njohin dhe respektojnë rregullimin ligjor dhe atë të brendshëm të FSHPS.
2. Anëtarët e regjistruar në FSHPS janë të detyruar të kontribuojnë nëpërmjet pagimit të kuotizacioneve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme.
3. Selia e një anëtari të FSHPS-së është në territorin Shqiptar.

### **Neni 5**

#### **E DREJTA E FITIMIT TË ANËTARËSISË**

1. Cilido subjekt sipas ligjit mund të kërkojë antarësimin në FSHPS vetëm mbasi të jetë regjistruar në regjistrin e institucionit përkatës kompetent në përputhje me rregullat e legjislacionit Shqipëtar në fuqi.
2. Komiteti Drejtues i jep aplikuesit të drejtën e të qenit anëtar provizor në FSHPS pa të drejtë vote deri në asamblenë e radhës.
3. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi anëtarësinë e një anëtari, por ajo nuk mund ta refuzojë atë përderisa organizmi i kërkuesit nuk është në kundërshtim me statutin e FSHPS dhe legjislacionit në fuqi.

### **NENI 6**

#### **TË DREJTAT E ANËTARËVE**

Anëtari i Federatës Shqipëtare të Peshkimit Sportiv ka të drejtë:

1. Të pajiset me kartën anëtarësimi (personat fizikë subjekte të regjistruar të këtij sporti);
2. Të pajiset me statutin dhe rregulloret e Federatës Shqiptare të Peshkimit Sportiv;
3. Të përfaqësohet me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme;



4. Të informohet me vendimet e Komitetit Drejtues të FSHPS;
5. Të pajiset falas me botimet e ndryshme që bën FSHPS;
6. Të marrë pjesë në aktivitetet zyrtare e miqësore, kombëtare dhe ndërkombëtare që organizon FSHPS;
7. Të njihet më parë me programin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme dhe dokumentacionin përkatës.

#### **NENI 7** **DETYRIMET E ANËTARËVE**

- Të tregojë një marrëdhënie korrekte ndaj FSHPS-së, që nënkupton që çdo anëtar të mos ndërmarrë veprime kundër interesave të FSHPS-së dhe të respektojë të drejtat dhe detyrimet statutores dhe ligjore;
- Të paguajë të gjitha detyrimet financiare ndaj FSHPS-së;
- Ti komunikojë FSHPS-së cdo ndryshim me statutet dhe rregulloret e anëtarit si dhe listë të personave ose zyrtarëve me të drejtë firme për të hyrë në marrëveshje ligjore me palët e treta;
- Të pranojë dhe t'u nënshtrohet statuteve dhe rregulloreve të FSHPS-së dhe organizmave ndërkombëtare;
- Për Asamblesë e vet të Përgjithshme, sipas organizimit të brendshëm, të zgjedhë organet drejtuese, ekzekutive dhe nëse e gjykon të arsyeshme dhe organin e vet disiplinor;
- Të njohë parimet e ndershmërisë, integritetit dhe sjelljes korrekte sportive;
- Të njohë të gjitha detyrimet e tjera që dalin nga keto statute, rregullore, direktiva dhe vendime të FSHPS-së;
- Të njohë autoritetin e Keshillit të Arbitrazhit Sportiv (KAS) pranë Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe të Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv në Lausanë, Zvicër për të gjitha çështjet që lidhen me konflikte objekt i Rregullores së KAS dhe KOKSH.
- Të njohë dhe pranojë autoritetin dhe vendimet e organeve përkatëse ligjore sportive në veprimtarinë e sportit, si brenda Federatës ashtu edhe jashtë saj.



**NENI 8**  
**PEZULLIMI**

1. Shkelja serioze e statutit, rregulloreve, direktivave dhe vendimeve të FSHPS-së i jep të drejtën Asamblesë së Përgjithshme të pezullojë çdo anëtar të saj nga antarësimi i FSHPS-së, së për një periudhë, e cila parashikohet nga Asambleja e Përgjithshme.
2. Në raste urgjente K.D. mund të japë pezullim provizor deri në Asamblenë e radhës e cila do të shprehet me një vendim për vendimin e K.D-së.
3. Çdo vendim pezullimi përbën humbjen e të drejtave që lidhen me statusin e anëtarit për sa kohë që pezullimi mbetet në fuqi.
4. Ndaj vendimeve për pezullim anëtarit ka të drejtë të ankohet sipas ligjit dhe këtij Statuti.

**NENI 9**  
**HUMBJA E STATUSIT TË ANËTARIT**

1. Statusi i anëtarit mbaron me dorëheqjen ose përjashtimin e anëtarit.
2. Humbja e statusit të anëtarit nuk e liron atë nga detyrimet e veta financiare të papërbushura kundrejt FSHPS-së ose anëtarëve të tjerë. Pezullimi e përjashton atë nga të gjitha të drejtat që lidhen me FSHPS, veçanërisht nga ato që lidhen me kapitalin e FSHPS.

**NENI 10**  
**DORËHEQJA E ANËTARIT**

1. Një anëtar mund të paraqesë me shkrim kërkesën e tij për dorëheqje, dorëheqja hyn në fuqi vetëm me perfundim të vitit financiar. Kërkesa duhet të paraqitet të paktën 30 ditë më parë nga mbyllja e vitit financiar.

**KREU III**  
**ORGANIZIMI**

**NENI 11**  
**ORGANET E FEDERATËS SHQIPTARE TË PESHKIMIT SPORTIV**

Organet e FSHPS-së janë:



1. Asambleja e Përgjithshme;
2. Presidenti;
3. Komiteti Drejtues;
4. Sekretari i Përgjithshëm;

Komisionet:

1. Komisioni i Disiplines;
2. Komisioni i Apelit
3. Komisioni Tekniko-Arbitër
4. Komisioni i Financës

## **NENI 12**

### **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë i FSHPS-së. Vetëm një Asamble e mbajtur në përputhje me rregullat e këtij statuti ka autoritetin të marrë vendime.
2. Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga të gjithë anëtarët e saj të cilët kanë të drejtën e 1 (një) vote , nëpërmjet një përfaqësuesi me mandat.
3. Mund të marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme pa të drejte vote anëtarët e nderit të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, anëtarët e Komitetit Drejtues, Sekretari i Përgjithshëm i FSHPS-së.
4. Komiteti Drejtues vendos mbi pjesëmarrjen e personave të tjerë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
5. Këta persona nuk kanë të drejtë vote dhe mund të diskutojnë vetëm me leje të drejtuesit të Asamblesë.

## **NENI 13**

### **KOMPETENCAT E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**

Asambleja e Përgjithshme e FSHPS-së ka këto kompetenca:

- a) Miraton ndryshime të statutit të FSHPS-së në përputhje me ligjin për sportin;
- b) Miraton llogaritë vjetore të Federatës Shqiptare të Peshkimit Sportiv;
- c) Miraton raportin e Komitetit Drejtues të FSHPS-së;
- d) Voton buxhetin e FSHPS-së;



- e) Miraton organin e kontrollit financiar të pavaruar nga FSHPs-ja sipas ligjeve në fuqi;
- f) Përcakton numrin e plotë të anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme;
- g) Zgjedh Presidentin e FSHPs-së;
- h) Zgjedh anëtarët e Komitetit Drejtues;
- i) Miraton propozimet e anëtarëve për dhënie të titujve të nderi brënda juridiksionit të Federatës Shqiptare të Peshkimit Sportiv;
- j) Miraton pranimin, pushimin, pezullimin apo dorëheqjen e një anëtari sipas parashikimit në këtë statut.
- k) Heq mandatin e një anëtari apo të organeve të federatës sipas parashikimit në këtë statut;
- l) Deklaron shkrimin e Federates dhe likuidimin e veprimeve të saj financiare;
- m) Miraton kalendarin e aktiviteteve të programuara nga K.D;
- n) Si dhe kompetenca të tjera që caktohen nga legjislacioni në fuqi.

#### **NENI 14** **EMËRIMI I DELEGATËVE**

Anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të FSHPs-së janë të lirë për të zgjedhur apo përcaktuar konform rregullimit të tyre të brendshëm përfaqësuesit e tyre me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme të FSHPs-së duke i pajisur me mandat përfaqësimi.

1. Anëtarët (klubet, shoqatat etj) dërgojnë pranë FSHPs-së personat zyrtarë të autorizuar për përfaqësimin e tyre.
2. Delegatët zyrtarë duhet të kenë dokumentin zyrtar (autorizim, prokurë të shoqatës, klubit sportiv etj) të anëtarit të Federatës që vërteton se ai është përfaqësues me të drejtë vote.
3. Delegatët zyrtarë duhet të kenë dokument identifikimi (pasaportë ose Letërnjoftim).
4. E drejta e votës nuk mund ti delegohet një anëtari tjetër të Federatës.
5. Anëtarët (klubet, shoqatat) janë të detyruar që të sjellin emrat e personave të autorizuar për tu përfaqësuar me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme, pranë Sekretariatit të FSHPs-së jo më vonë se 20 ditë përpara datës së zhvillimit të Asamblesë.



**NENI 15**  
**NUMRI I PËRCAKTIMI I DELEGATËVE**  
**(Parimi një anëtar një votë)**

1. Numri i delegatëve përcaktohet si më poshtë:
  - a) Çdo klub sportiv që është i licensuar në federatë dhe merr pjesë në gara dhe aktivitete të tjera sportive ka 1 (një) delegat.
  - b) Çdo shoqatë sportive që është e licensuar në federatë dhe merr pjesë në gara dhe aktivitete të tjera sportive ka 1 (një) delegat.
  - c) Shoqata e gjyqtarëve që është e licensuar në federatë dhe merr pjesë në gara dhe aktivitete të tjera sportive ka 1 (një) votë.
2. Cdo delegat ka të drejtën e 1 (një) vote.

**NENI 16**  
**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ZAKONSHME**

1. Asambleja e Përgjithshme e zakonshme thirret nga K.D. jo më pak se një herë në vit. Njoftimi për mbledhjen e Asamblese duhet tu dërgohet anëtarëve 30 ditë përpara ditës së zhvillimit të saj.
2. Rendi i ditës vendoset nga KD. Rendi i ditës, raportet e aktiviteteve, buxheti, llogaritë, dhe cdo dokument tjetër duhet t'u dërgohet anëtarëve 10 ditë përpara datës së mbledhjes.
3. Çdo anëtar ka të drejtë të propozojë përfshirjen në rendin e ditës të një çështjeje. Kjo kërkesë duhet të paraqitet në sekretariatit e FSHPS-së 7 ditë përpara mbledhjes dhe të miratohet nga Asambleja në mbledhje.

**NENI 17**  
**RENDI I DITËS PËR ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË ZAKONSHME**

1. Rendi i ditës për Asamblenë e përgjithshme të zakonshme duhet të përfshijë të paktën çështjet e mëposhtme:
  - a) Verifikimi i përbërjes së mbledhjes, verifikimi i mandateve.





- b) Raporti i presidentit.
  - c) Zgjedh anetaret e Komisionit të Verifikimit të mandateve, anetaret e komisionit zgjedhor.
  - d) Zgjedhjet për cdo vënd vakant.
  - e) Shqyrtimi i propozimeve për amendamentet në statutin e FSHPS-së
  - g) Diskutime nga anëtarët për çështje të tjera të ndryshme që lidhen me veprimtarinë e Federatës.
- 2) Rendi i ditës mund të modifikohet në Asamble nga një mazhorancë që përbën 2/3 e anëtarëve të Federatës para fillimit të punimeve të Asamblesë për çështje që nuk parashikojnë ndryshime statutores, shkarkime apo zgjedhje të organeve drejtuese.

## NENI 18

### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E JASHTËZAKONSHME

K.D. mund të thërrasë një Asamble të Përgjithshme të Jashtëzakonshme, nëse mendohet se kjo është e domosdoshme në varesi të rrethanave të Federatës.

Kur të paktën 1/3 e anëtarëve të Federatës bëjnë kërkesë me shkrim, K.D. është e detyruar të thërrasë një Asamble të Përgjithshme të jashtëzakonshme jo më vonë se 2 muaj pas marrjes së kërkesës. Nëse asambleja nuk thirret nga K.D. ose kërkesa nuk shqyrtohet, anëtarët që kërkuan atë, mund ta thërrasin mbledhjen vetë, duke ngarkuar një kryetar të përkohshëm me një grup pune për organizmin dhe mbarevajtjen e Asamblese së Jashtëzakonshme.

Njoftimi për mbledhjen e asamblesë së jashtëzakonshme duhet tu dërgohet anëtarëve 30 ditë para ditës së zhvillimit të saj.

Rendi i ditës si dhe çdo dokument tjetër duhet tu dërgohen anëtarëve 10 ditë përpara datës së mbledhjes.

K.D. vendos për rendin e ditës kur Asamblenë e thërret KD. Kur Asambleja e Jashtëzakonshme mbahet me kërkesën e 1/3 të anëtarëve, rendi i ditës caktohet nga 1/3 e anëtarëve kërkuar dhe duhet të përmbajë pikat e ngritura nga këta anëtarë në përputhje me këtë Statut.



Rendi i ditës nuk mund të ndryshohet gjatë Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme.

## **NENI 19**

### **VENDIMMARRJA**

1. Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme kur janë prezent më shumë se gjysma e anetareve (50% + 1) që kanë të drejtë të votojnë me përjashtim të pikës 2 të këtij neni.
2. Nëse shumica e thjeshtë (50%+1) nuk arrihet, një Asamble tjetër e Përgjithshme duhet të bëhet 24 ore pas të parës, me të njëjtin rend dite. Nuk kërkohet shumicë për mbledhjen e dytë, përveç rasteve kur në rendin e ditës janë parashikuar amendamente në statutin e Federatës, zgjedhja e Presidentit dhe e anetareve të K.D-së, përjashtimi ose pezullimi i një anëtari të Federatës ose shkrirja e Federatës.
3. Asambleja e Përgjithshme nuk duhet të marrë vendime për çështje që nuk janë parashikuar në rendin e ditës.
4. Vendime duhet të merren me votim të hapur me përjashtim të rastit kur 1/3 e delegatëve kërkojnë votim të fshehtë ose kur votimi kryehet për zgjedhje organesh ose për çështje individuale.
5. Vendimet e marra nga Asambleja hyjnë në fuqi menjëherë, me përjashtim të rasteve kur Asambleja vendos për një datë të mëvonshme ose ja delegon këtë të drejtë KD.

## **NENI 20**

### **DREJTIMI I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**

1. Asambleja e Përgjithshme duhet të drejtohet nga Presidenti, ose në mungesë të tij nga zëvendës-presidenti. Kur edhe ai mungon mbledhja drejtohet nga anëtari më i vjetër i K.D duke u emeruar kryetar dite.



2. Asambleja cakton komisionin e verifikimit te mandateve të përbërë prej 3 personash delegatë në Asamble.
3. Drejtuesi i mbledhjes është përgjegjës për respektimin e rendit të ditës dhe mbarevajtjen e Asamblese. Ai përcakton edhe kohën në dispozicion të cdo anëtari për diskutim.
4. Procedura e mbajtjes së procesverbalit të mbledhjes së Asamblesë drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm i cili i dërgon atë për njoftim tek anëtarët brenda 20 ditëve mbas datës së mbledhjes.
5. Procesverbali i cdo mbledhjeje të Asamblesë do të nënshkruhet nga të gjithë delegatët votues.

## **NENI 21**

### **ZGJEDHJET**

Zgjedhjet për organet drejtuese të Federatës bëhen me votim të fshehtë.

Zgjedhjet mund të bëhen mbi bazën e kuorumit 50% + 1 të anëtarëve të Federatës. Në zgjedhje shpallet fitues kandidati që ka marrë më shumë vota. Në rast se në votimin e parë votat janë të njëjta, zhvillohet një raund i dytë midis kandidatëve me vota të barabarta. Në këtë rast shpallet fitues kandidati që ka marrë më shumë vota. Në rast se përsëri ky votim është i barabarte, zgjedhjet do të zhvillohen edhe njëherë dhe në rast se ka perseri barazim votash, kandidatet duhet të përcaktohen nga shorti, i cili organizohet nga komisioni i zgjedhjeve.

Zgjedhja e Presidentit të Federatës bëhet me 2/3 e votave të delegatëve prezent në mbledhje. Në rastet kur asnjë nga kandidatët nuk arrin të marrë 2/3 e votave, atëherë zhvillohet një raund zgjedhjesh midis dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave në raundin e parë. Në raundin e dytë kandidati me numrin më të madh të votave zgjidhet. Në rast se numri i votave në raundin e dytë është i barabartë, zgjedhjet midis dy kandidateve ripërsëriten dhe në rast se ka sërish barazim votash, atëherë kandidatura fituese përcaktohet me short nga komisioni i zgjedhjeve.



Çdo kandidat për organe drejtuese duhet të propozohet nga të paktën një anëtar i Federates, jo më vonë se 20 ditë para datës së asamblesë, në rendin e ditës të së cilës është vendosur zgjedhje për organe drejtuese. Secili kandidat duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara nga ky Statut dhe legjislacioni në fuqi, kërkesa që verifikohen nga K.D. ose nga një grup pune i autorizuar nga K.D. ose nga grupi i punës që organizon asamblenë.

## **NENI 22**

### **PRESIDENTI**

Kandidati për President duhet:

- të jetë shtetas shqiptar, me banim në Shqipëri;
- të ketë arsim të lartë;
- të ketë figurë të pastër morale;
- të ketë moshën mbi 30 vjec;
- të mos jetë i dënuar nga organet e drejtësisë shqiptare dhe ato të huaj.
- të mos ketë konflikt interesash me postin e Presidentit;
- të mos jetë njëkohësisht trajner, vëzhgues, sekretar klubi, apo anëtar i një organi të Federates. Në këto raste, kandidati për president duhet të ketë dhënë dorëheqjen nga këto pozicione paraprakisht.

## **NENI 23**

### **DETYRAT E PRESIDENTIT**

Detyrat e Presidentit janë si më poshtë:

- Të përfaqësojë Federatën si vetmi përfaqësues i saj me cdo palë të tretë;
- Të kërkojë thirrjen e A.P dhe të thërras mbledhjet e K.D-së;
- Të drejtojë Asamblenë e Përgjithshme po ashtu edhe mbledhjet e K.D-së;



- Të sigurojë zbatimin e vendimeve të A.P dhe të K.D.-së;
- Të lëshojë certifikatat e trajnimeve, licencimet dhe çdo autorizim përkatës miratues për ushtrim veprimtarie në fushën e peshkimit sportiv.
- Në rast se presidenti mungon detyrat mund ti ngarkohen Zëvendës-presidentit, (Zëvendës-presidenti zgjidhet nga K.D. me propozim të Presidentit).

Në rastin kur presidenti jep dorëheqjen K.D., cakton Zëvendës-presidentin që të kryejë funksionet e presidentit përkohësisht, deri në zgjedhjen e Presidentit nga Asambleja e Përgjithshme.

## **NENI 24**

### **KOMITETI DREJTUES**

Komiteti Drejtues përbëhet nga 5 anëtarë. Presidenti është anetar ex officio i K.D.

Kandidati për anëtar i K.D. duhet:

- të jetë shtetas shqiptar, me banim në Shqipëri;
- të ketë arsim të lartë;
- të ketë figurë të pastër morale;
- të mos jetë i dënuar nga organet drejtësisë shqiptare dhe të huaj.
- të mos jetë njëkohësisht trajner, vëzhgues, sekretar klubi, apo anetar i një organi të Federatës. Në këtë rast kandidati duhet të ketë dhënë dorëheqjen nga këto pozicione paraprakisht;
- të jete i propozuar nga një anetar i Federatës;
- të mos ketë konflikt interesash me të qenit anëtar i K.D.;



## **NENI 25**

### **KOHEZGJATJA E MANDATEVE**

Mandati i Presidentit, zv/presidentit dhe anëtarëve të Komitetit Drejtues është 4 vjeçar.

Ata kanë të drejtë të rikandidojnë.

## **NENI 26**

### **MBLEDHJET E KOMITETIT DREJTUES**

K.D. mbledhet jo më pak se gjashtë herë në vit

Mbledhja e K.D drejtohet nga Presidenti

Presidenti ben njoftimin për mbledhje 14 ditë përpara zhvillimit të mbledhjes. 1/3 e anëtarëve të K.D., mund të kërkojnë presidentit mbledhjen e K.D-se jashtë radhe.

Presidenti duhet të thërrasë mbledhjen brenda 3 (tre) javëve pas marrjes së kërkesës.

Sekretari i Përgjithshëm duhet të marrë pjesë në takimet e K.D.-se pa të drejtë vote.

Sekretari i Përgjithshëm mban procesverbalin e mbledhjes.

Mbledhjet e K.D-se mbahen të hapura ose të mbyllura, sipas vendimit të KD.

K.D. mund të ftojë palë të treta të marrin pjesë. Këto palë të treta nuk kanë të drejtë votimi dhe mund të shprehen në mbledhje vetëm me miratimin të drejtuesit të mbledhjes.

Për mbledhjet e K.D.-së mbahet procesverbal, i cili firmoset nga Presidenti, Sekretari i Përgjithshëm dhe nga anëtarët prezent. Vendimet duhet të zbardhen brenda pesë (5) ditëve dhe të bëhen publike.



## NENI 27

### KOMPETENCAT E KOMITETIT DREJTUES

K.D. ka këto kompetenca:

- Të menaxhojë dhe drejtojë punët e Federatës me Vendime;
- Të planifikojë dhe miratojë aktivitetet dhe kalendarin e veprimtarive kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Të përcaktojë për secilin punonjës të Federatës përshkrimin e punës;
- Të monitorojë administrimin e Federatës;
- Të zgjedhë zëvendës-presidentin me propozim të Presidentit;
- Të miratojë projekt-buxhetin dhe ta paraqesë në asamblenë e përgjithshme;
- Të emerojë dhe shkarkojë anëtarët e organeve gjyqësore dhe të Komisioneve të Federatës.
- Të përcaktojë, organizojë dhe anullojë aktivitete zyrtare të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Të mbajë lidhje me organizata ndërkombëtare dhe gjithashtu të ushtrojë të drejtën për të propozuar përfaqësues të Federatës për tu zgjedhur në këto organizata.
- Të miratojë rregulloret e brendshme përkatëse për organizimin dhe trajnimet përkatëse.

## NENI 28

### VENDIMARRJA

K.D. fillon mbledhjen vetëm kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve.

K.D. merr vendime me 50% + 1 të anëtarëve të pranishëm. Në rastin e votave të barabarta Presidenti ka votë vendimtare kur votimi është i hapur.



Në rast se një anëtar i K.D.-së ka konflikt interesash me çështjen për të cilën debatohet ai përjashtohet nga debati dhe votimi për këtë çështje. Në raste të votimeve për çështje individuale votimi në K.D. është i fshehtë.

Vendimet e marra regjistrohen në procesverbal dhe ruhen në arkivën e FSHPS.

Vendimet e marra nga K.D. hyjnë në fuqi menjëherë përveç rasteve kur KD vendos ndryshe.

#### **KREU IV**

#### **NENI 29**

#### **SEKRETARI I PËRGJITHSHEM**

Sekretari i Përgjithshëm është organ administrativ i FSHPS-së.

1. Ministri përgjegjës për Sportet miraton njerën nga dy kandidaturat për Sekretar të Përgjithshëm të propozuar nga K.D. i cili do të administrojë fondin grant të dhënë nga Ministria përgjegjëse për Sportin duke qënë edhe firma e autorizuar në thesar për këtë çështje.
2. Sekretari i Përgjithshëm mund të pezullohet nga K.D për shkelje të rënda statutores apo abuzime të ndonjë natyre tjetër.

Kandidati për Sekretar të Përgjithshme duhet:

- Të jetë shtetas Shqipëtar, me banim në Shqipëri;
- Të ketë arsim të lartë;
- Të ketë figurë të pastër morale;
- Të ketë moshën mbi 30 vjeç;
- Të mos jetë i dënuar nga organet e drejtësisë shqiptare dhe ato të huaja.
- Të mos jetë njëkohësisht trajner, gjyqtar, vëzhgues, sekretar klubi apo anëtar i një organi gjykues të FSHPS-se;
- Të mos ketë konflikt interesash me të qenit Sekretar i Përgjithshëm.

Funksionet e tij janë:





- Të zbatojë vendimet e Komitetit Drejtues dhe Presidentit;
- Të bëjë përgatitjet për Asamblenë e Përgjithshme dhe për mbledhjet e organeve të tjera të Federates.
- Te programojë rendin e ditës së Asamblesë së Përgjithshme dhe të takimeve të K.D.-së, sipas vendimeve përkatëse.
- Të mbajë korrespondencën e Federates;
- Sekretari i Përgjithshme është drejtues i Sekretariatit të Federatës;
- Ai është përgjegjës për veprimtarinë financiare të Federatës.
- Ai merr pjesë rregullisht në Asamblenë e Përgjithshme, takimet e K.D.-së dhe në ato të Komisioneve.

### **NENI 30**

#### **PERJASHTIMI DHE SHKARKIMI I NJE PERSONI TE ZGJEDHUR**

K.D. mund të pezullojë një anëtar të KD-së për shkelje statutores, abuzime financiare të faktuara nga organi kompetent apo për shkelje ligjore.

Asambleja e Përgjithshme ka autoritetin që ta shkarkojë një anëtar të K.D., kur propozimi për përjashtim votohet me 2/3 e anëtarëve prezent në Asamble.

Kur 1/3 e anëtarëve që përbën Asamblenë e Përgjithshme kërkon shkarkimin e Presidentit, Asambleja e Përgjithshme ka autoritetin për të marrë vendime kur ky propozim votohet nga 2/3 e anëtarëve prezent të Asamblese

### **KREU V**

#### **FINANCA**

### **NENI 31**

#### **PERIUDHA FINANCIARE**

Periudha financiare do të jetë viti kalendarik prej 1 Janarit deri në 31 Dhjetor, dhe në cdo rast sipas legjislacionit fiskal në fuqi.



## **NENI 32**

### **BURIMET FINANCIARE**

1. Të ardhurat e Federates sigurohen nga:

- a). Granti i përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve;
- b). Regjistrimet vjetore të anëtarëve;
- c). Të ardhurat e krijuara nga marketingu i të drejtave që gëzon Federata Shqiptare e Peshkimit Sportiv;
- d). Nga sponsorizimet, donacionet, dhurimet, financimet nga shteti si dhe burime të tjera të ligjshme;
- e). Nga licensimi i tranierëve, vëzhguesve, specialistëve, amatorëve;
- f). Nga kuotat e anëtarimit në Federatën Shqiptare të Peshkimit Sportiv.

## **NENI 33**

### **ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE**

Të gjitha mosmarrëveshjet që përfshijnë si palë Federatën, çështje të lidhura me të, si dhe mosmarrëveshjet midis anëtarëve të Federatës apo personave të lidhur me to do të zgjidhen me mirekuptim në Komisionin e Federatës dhe në rast se nuk gjen zgjidhje në Komisionin përkatës, këto mosmarrëveshje do të shqyrtohen në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv (KAS) pranë Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar.

## **KREU VI**

### **DISPOZITAT E FUNDIT**

## **NENI 34**

1. Për çështjet që nuk parashikohen në këtë statut do të referohet në dispozitat të ligjit nr. 9376 date 21.04.2005 "Per Sportin", Kodit Civil, ligjit nr. 8788 datë 07.05.2001 "Për



# **FEDERATA SHQIPTARE E PESHKIMIT SPORTIV**

Adresa: Rr."Hoxha Tahsin", Pallati Vjetro, Nr.1, Shk.1, Ap.2, Tirane

---

Organizatave Jofitimpruese", si dhe ligjit 8789 datë 07.05.2001 "Për rregjistrimin e Organizatave Jofitimpruese"(i ndryshuar), si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë aktivitet, ekzistuese apo edhe ato që do të dalin dhe hyjnë në fuqi në të ardhmen.

2.Cdo ndryshim i statutit të Federatës, përpara se të rregjistrohet ne Gjykatën kompetente miratohet me Urdher të Ministrit të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve sipas parashikimeve ligjore.

3. Në rast mosmarreveshje brenda Federatës, të cilat cojnë në paralizimin e aktivitetit dhe veprimtarisë së Federatës, Ministri përgjegjës për sportin ka të drejtë të pezullojë veprimtarinë e organeve drejtuese të Federatës dhe të miratojë me mandat të përkohshëm një kryetar të Federatës për të drejtuar veprimtarinë e kësaj Federate dhe për të përgatitur thirrjen e Asamblesë së Jashtëzakonshme Zgjedhore.

4. Ky Statut hyn në fuqi sipas parashikimeve ligjore në fuqi

## **ANËTARËT THEMELUES TË FEDERATËS SHQIPTARE TË PESHKIMIT SPORTIV**

### **Shoqata Shqiptare e Peshkimit Sportiv dhe Rekreativ**

**Shoqata "Peshkatarët Sportivë POSEIDON"**

**Shoqata "Illyrians Surfcasting Club Albania"**